



**RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK “PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË
EVADUARA NË GJATËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2023”**

**RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK
“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË GJATËMUJORIN E DYTË TË
VITIT 2023”**

MBI AUDITIMIN ME TEMË: “KUJDESI NDAJ TË MOSHUARVE”

NË SUBJEKTET:

- ✓ **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**
- ✓ **SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**
- ✓ **INSTITUCIONET REZIDENCIALE PËR TË MOSHUAR NË TIRANË, SHKODËR,
FIER, GJIROKASTËR, KAVAJË DHE QENDRA POLIVALENTE PËR
SHERBIMET E KUJDESIT SHOQËROR, POLIÇAN**
- ✓ **BASHKITË KAVAJË, FIER, GJIROKASTËR, POLICAN.**

PRILL 2025

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh,	3
3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh,	4
3. Statusi i pranimit të rekomandimeve:	4
II. HYRJA	5
1. Objekti i auditimit.....	5
2. Qëllimi auditimit:	5
3. Metodologjia e auditimit:	6
4. Konkluzioni:	6
5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:	7
III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM	7
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	23
ANEKSI 1	26

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 1488 prot, datë 12.12.2024 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë “Kujdesi ndaj të moshuarve”, evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023”, ushtroi auditim në 12 (dymbëdhjetë) subjektet pjesë e Auditimit të Përformancës me temë: “Kujdesi ndaj të moshuarve”, përkatësisht: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe institucionet e varësisë së saj, institucionet rezidenciale për të moshuar në Tiranë e Shkodër, institucionet rezidenciale për të moshuar në bashkitë Fier, Gjirokastrë, Kavajë dhe Qendra Polivalente Rezidenciale Poliçan.

Auditimi i kryer në vitin 2023, kishte si periudhë auditimi nga data 01.01.2020 deri më datë 30.06.2023 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin nr. 220 datë 20.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 446/17-22, datë 22.12.2023. *Auditimi u krye nga data 12.12.2024 deri më datë 17.01.2025*, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet objekt auditimi u mbajtën Akt-Verifikimet përkatëse të cilat janë regjistruar përkatësisht:

- në MSHMS me nr. 5019/1 prot, datë 17.01.2025
- në SHSSH me nr. 362 prot, datë 17.01.2025
- në Tiranë me nr. 32 prot, datë 17.01.2025
- në Kavajë me nr. 11 prot, datë 14.01.2025
- në Fier me nr. 78 prot, datë 14.01.2025
- në Gjirokastrë me nr. 20 prot, datë 16.01.2025
- në Poliçan me nr. 41 prot, datë 17.01.2025
- në Shkodër me nr. 329/2 prot, datë 15.01.2023

2. RESPEKTIMI I AFATIT LIGJOR PREJ 20 DITËSH,

Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi se nga 8 institucione përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të lëna: - për planin e masave, 7 institucione kanë kthyer përgjigje, ndërkohë që 1 institucion (Shtëpia e të Moshuarve Fier) nuk ka kthyer përgjigje.

Konkretisht:

Institucioni përgjegjës për zbatimin e rekomandimet e lëna	Kthim përgjigje 20 ditore nga subjekti
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	nr. 2007/6 datë 24.01.2024
Shërbimi Social Shtetëror	nr.7316/15 date 15.01.2024
Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	nr.22 datë 15.01.2024
Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	nr.30 datë 18.01.2024

Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë	nr.57 date 28.02.2024
Shtëpia e të Moshuarve Fier	Nuk ka kthyer përgjigje
Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	nr.10 datë 15.01.2024
Qendra Polivalente	nr.86 datë 26.02.2024

3. RESPEKTIMI I AFATIT LIGJOR PREJ 6 MUAJSH:

Për raportimin në KLSH, të ecursë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna". Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se 6 institucione kanë kthyer përgjigje, ndërkohë që 2 institucione (Shtëpia e të Moshuarve Fier dhe Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë) nuk kanë kthyer përgjigje.

Institucioni përgjegjës për zbatimin e rekomandimet e lëna	Kthim përgjigje 6 mujore nga subjekti
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	nr. 3329 datë 26.07.2024
Shërbimi Social Shtetëror	nr.4705 datë 18.06.2024
Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	nr.122 datë 25.06.2024
Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	nr.30/1 datë 30.06.2024
Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë	Nuk ka kthyer përgjigje
Shtëpia e të Moshuarve Fier	Nuk ka kthyer përgjigje
Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	nr.85 datë 03.06.2024
Qendra Polivalente	nr.163 datë 04.06.2024

✚ Sa më sipër, Shtëpitë e të Moshuarve Fier dhe Gjirokastrë nuk e kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.

3. STATUSI I PRANIMIT TË REKOMANDIMEVE:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me shkresat nr. prot.446/17-22, datë 21.12.2023, janë rekomanduar gjithsej:

✓ 17 masa organizative dhe 2 masa për përmirësime ligjore

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella mbi planin e masave, nga MSHMS është kthyer përgjigje me shkresën nr. 2007/6, datë 24.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 446/26, datë 29.01.2024; nga SHSSH, është kthyer përgjigje me shkresën nr. 7316/5, datë 15.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 446/24, datë 17.01.2024, nga Shtëpia e të Moshuarve Tiranë është kthyer përgjigje me shkresën nr. 22, datë 15.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 446/23, datë 16.01.2024, nga Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, është kthyer përgjigje me shkresën nr. 30, datë 18.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 446/29, datë 22.01.2024, nga Shtëpia e të Moshuarve Kavajë është kthyer përgjigje me shkresën nr. 10, datë 15.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 446/34, datë 17.01.2024, nga Shtëpia e të Moshuarve Poliçan, është kthyer përgjigje me Shkresën nr. 86, datë 26.02.2024, protokolluar në KLSH me nr. 446/28, datë 04.03.2024 (në lidhje me këtë subjekt rezultoi se shkresat mbi "Plani i masave" dhe përgjigje "Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve" ju referohen rekomandimeve të ndryshme, Rekomandimet për Shtëpitë e të Moshuarve janë ato të specifikuar në Planin e Masave, ndërsa përgjigja është dhënë për rekomandime të cilat i janë adresuar SHSSH), nga Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë, është kthyer përgjigje me Shkresën nr. 57, datë 28.02.2024, protokolluar në KLSH me nr. 446/27, datë 01.03.2024.

Mbi planin e masave, lidhur me rekomandimet e lëna rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Ligjore	2	2	0
2	Organizative	17	16	1

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në vitin 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 13.06.2021.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 1488 prot, datë 12.12.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në vitin 2023”. Rekomandimet e lëna në Raporti Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm me temë “*Kujdesi ndaj të moshuarve*” me konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin nr.220 datë 20.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresat nr. 446/17-22, datë 21.12.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. A. B, *përgjegjës grupi*,
2. B. A, *anëtar*
4. B. A, *anëtar*

Auditimi ka filluar më, 12.12.2024

Auditimi ka përfunduar më, 17.01.2025

1. Objekti i auditimit

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e performancës të evaduara në vitin 2023 me shkresat nr. 446/17-22, datë 21.12.2023, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Kujdesi ndaj të moshuarve*” të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror dhe institucionet e varësisë së saj, institucionet rezidenciale për të moshuar në Tiranë e Shkodër, institucionet rezidenciale për të moshuar në bashkitë Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Qendra Polivalente Rezidenciale Poliçan, sipas programit të auditimit nr. 446/6, datë 26.07.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datë 30.06.2023, në lidhje mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

2. Qëllimi i auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Qëllimi i auditimit është të vlerësojë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga auditimet e mëparshme, koherencën e tyre dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe Institucionet Rezidenciale për të moshuar në Tiranë, Shkodër si dhe në Institucionet Rezidenciale për të moshuar nën administrim të bashkive Fier, Gjirokastrë, Kavajë dhe Poliçan në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat e sipërcituara, rezulton se nga 19 (nëntëmbëdhjetë) masa të rekomanduara gjithsej të cilat janë pranuar nga subjektet e audituara. Nga këto masa:

- ✓ janë zbatuar **3 rekomandime** ose 17 % e tyre,
- ✓ janë zbatuar pjesërisht **4 rekomandime** ose 22 % e tyre,
- ✓ gjenden në proces zbatimi **10 rekomandime** ose 56% e tyre,
- ✓ nuk janë zbatuar **2 rekomandime** ose 11 % e tyre

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Papranuar	Statusi i zbatimit			
				Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Ndryshime apo përmirësime ligjore	2	0	-	-	2	-
2	Masa organizative	17	1	3	4	8	2
	Gjithsej	19	1	3	4	10	2

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave për ndryshim apo përmirësim ligjor	Në numër	Në %
1	Totali	2	100
2	Pa pranuar	-	-
3	Pranuar	2	100
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	-	-
2	Zbatuar pjesërisht	-	-
3	Në proces zbatimi	2	100%
4	Pa zbatuar	-	-

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	19	100
2	Pa pranuar	1	0
3	Pranuar	18	99.90
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave

1	Zbatuar Plotësisht	3	17%
2	Zbatuar pjesërisht	4	22%
3	Në proces zbatimi	10	56%
4	Pa zbatuar	2	11%

5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është rreth 17 %, për disa nga masat organizative të lëna (institucionet) nuk kanë mundur të realizojnë tërësisht ato. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna dhe garantimin e një menaxhimi më të mirë të kujdesit ndaj të moshuarve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. MASA PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME LIGJORE

Për pyetjen audituese: 1 A ofron sistemi i kujdesit ndaj të moshuarve kapacitet njerëzor dhe infrastrukturor të përshtatshëm për realizimin e objektivave institucionale dhe strategjike?

Nënpyetja 1.2 A janë kushtet infrastrukturor të IR në përputhje, me kujdesin social? (Trajtuar më hollësisht në fq 22-31 të Raportit Përfundimtar)

3. Gjetje nga auditimi: Komisioni i SHSSH-së dhe Komisionet vendore (të ngritura pranë Bashkive) kanë vendosur kritere për pranimin në IR të personave të moshuar përtej përcaktimeve të VKM-së nr. 518 datë 04.09.2018.

3.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për rishikimin dhe përmirësimin e kërkesave dhe kritereve të pranimit të të moshuarave në Institucionet Rezidenciale Publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Shërbimit Social Shtetëror ngriti grupin e punës me Urdhër nr.55, datë 31.01.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e kritereve dhe dokumentacionit të pranimit të të moshuarve në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror dhe hartimin e propozimeve për ndryshimin e VKM-së nr.518, datë 04.09.2018”. Grupi i punës vlerësojë kriteret dhe dokumentacionin e pranimit të të moshuarve në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror dhe doli në propozime përkatëse për ndryshimin e VKM-së nr.518, datë 04.09.2018.

Referuar propozimeve të dala nga grupi i punës, Shërbimi Social Shtetëror, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën me nr.1317 prot, datë15.02.2024 me propozime për rishikimin e VKM-së 518, datë 04.09.2018.

Lidhur me këto propozime janë bërë takime me MSHMS, ku është dakordësuar që në fillim të vitit 2025 do të fillojë procesin e rishikimit të Ligjit 121/2016 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Bashkëlidhur do të gjeni shkresën nr.1317 prot, datë15.02.2024 me propozime për rishikimin e VKM-së 518, datë 04.09.2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Me gjithë përpjekjet dhe masat e marra nga SHSSH ende nuk është konkluduar me një akt konkret të ndryshuar apo të rishikuar.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

6. Gjetje nga auditimi: Të moshuarit e akomoduar në institucionet rezidenciale, që nuk kanë të ardhura dhe që kanë mbushur moshën e daljes në pension (65 vjeç), përveç shërbimit në rezidencë, përfitojnë edhe pension social prej 6,000 lekë. Ky përfitim, nuk përputhet me rregullat që parashikohen në ligjin për sigurimet shoqërore, i cili përcakton se mosha për përfitimin e këtij lloji pensioni është 70 vjeç.

6.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, të bashkëpunojë me Institutin e Sigurimeve Shoqërore për të rregulluar dhe unifikuar moshën e përfitimit të pensionit social për personat që vendosen në IRP dhe përfitojnë falas shërbimet sociale shtetërore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Lidhur me këtë rekomandim mosha e përfitimit të pensionit social është përcaktuar në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar), neni 5/1, ku përcaktohet se pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç dhe nuk mund të rregullohet me marrëveshje bashkëpunimi.

Bazuar në VKM-së 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, Kreu V, pika 68, germa a) personave të moshuar që nuk kanë të ardhura, që janë të vendosur në shërbimin rezidencial për të moshuarit u jepet 6000 lekë në muaj për shpenzime personale, përfitim i cili i jepet edhe kategorive të tjera përfituese të shërbimit rezidencial publik sipas përcaktimeve në VKM. Pra, kjo masë nuk është pension social por, shërben për të mbuluar nevojat personale të përfituesve të vendosur në IRP që nuk kanë të ardhura (pension) pavarësisht moshës së të moshuarit.

Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 1317 prot, dt.15.2.2024 ka propozuar ndryshimin e VKM-së 518/2018 dhe rishikimin e masës së shumës për shpenzime personale parashikuar në Kreun V, pika 68.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit ky rekomandim nuk është arritur të zbatohet por parashikohet të realizohet brenda 3 mujorit të parë të vitit 2025

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

B. MASA ORGANIZATIVE

Për pyetjen audituese: 1 A ofron sistemi i kujdesit ndaj të moshuarve kapacitet njerëzore dhe infrastrukturore të përshtatshme për realizimin e objektivave institucionale dhe strategjike?

Nënpyetja 1.1 A kanë institucionet rezidenciale për të moshuar burime njerëzore të kualifikuara me qëllim realizimin cilësor të shërbimeve? (Trajtuar më hollësisht në fq. 16-22 të Raportit Përfundimtar)

1. Gjetje nga auditimi: Nëpër Institucionet Rezidenciale Publike për të moshuarit, nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standardeve të përkujdesit shoqëror. Pavarësisht shtimit të personelit me kujdestarë, rezulton se ato janë punësuar me kohë të pjesshme dhe koha e shërbimit të tyre është e pamjaftueshme.

1.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkitë Fier, Poliçan, Gjirokastrë, Kavajë, të marrin masat përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë me kohë të plotë dhe shoqërimin e kësaj me shtim fondi buxhetor për efektet financiare të nevojshme.

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Shërbimi Social Shtetëror duke u bazuar në VKM nr.135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”, si dhe nisur nga nevojat e institucioneve të përkujdesit shoqëror për përmirësimin e shërbimeve të ofruara, ka dërguar shkresën me nr. 2448/1 prot, datë 22.04.2024, “Kërkesë për rishikimi e strukturave organizative të Institucioneve të përkujdesit shoqërorë për të moshuar”, pranë Bashkive Poliçan, Fier, Gjirokastrë dhe Kavajë për të sjellë ndryshimet, apo propozime të strukturës për institucionet e përkujdesit shoqëror për të moshuar, në mënyrë që shërbimi në këto institucione mos të ketë mangësi.

Gjatë kësaj periudhe, Shërbimi Social Shtetëror ka marrë masa për shtim në organikë për pozicionin kujdestar, me dy punonjës, në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, me shkresë nr.7623/1 prot, datë 07.10.2024 dhe shtimi i kujdestarëve në pesë institucionet e tjera rezidenciale për të moshuar është në proces shqyrtimi dhe realizimi. Sqarojmë se në zbatim të VKM-së 850/2026, parashikohet që institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, dhe shërbimi shoqëror, që ofrohet në to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin dhe personelin. Që nga momenti i transferimit, është bashkia që përballon me fonde shtimin e personelit apo investimet e nevojshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pavarësisht nismave të ndërmarra nga Shërbimi Social Shtetëror, numri i stafit nëpër shtëpitë e të moshuarve ende nuk është rishikuar dhe shtuar, ndaj nevojiten përpjekje të vazhdueshme nga ana e SHSSH dhe bashkive respektive për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e këtij rekomandimi.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i **pranuar dhe në proces zbatimi**.

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se stafi i punësuar nuk ka patur dhe kryer trajnime nga Shërbimi Social Shtetëror apo dhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe nuk janë kryer as trajnime me iniciativë personale.

2.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të marrin masa për kryerjen e trajnimeve periodike lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin e Institucioneve Rezidenciale publike për të moshuarit.

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 trajnimet e realizuara me stafet e Institucioneve Rezidenciale për të moshuar janë dy:

- Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar bashkëpunimin me European Commission, Sue Ryder Care Albania dhe Bashkinë e Tiranës për trajnimin e Përgjegjësve Social dhe Psikologëve të institucioneve rezidenciale dhe ditore për të moshuarit, trajnim 3 (tre) ditore (20, 21 dhe 22 maj 2024), me temë “Fuqizimi i kujdesit për të moshuarit: Një qasje gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve të mirë koordinuara për të moshuarit”.

- Shtëpia e të Moshuarve Shkodër në bashkëpunim me organizatën “Help for life” ka organizuar trajnimin e stafit gjatë muajit dhjetor, mbi temën “Kujdesi mjekësor për të moshuarit”, trajnim i akredituar.

Shërbimi Social Shtetëror në planin e punës për vitin 2025 do të ketë në objektivat e tij edhe trajnimin e stafeve të institucioneve rezidenciale për të moshuar lidhur me zbatimin e standardeve

të reja për të moshuarit, dalë me Udhëzimin nr.168 prot, datë 29.03.2024, “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Bazuar në përgjigjet e subjektit rezulton se përveç trajnimeve të realizuara për punonjësit social dhe psikologët e institucioneve rezidenciale, Shërbimi Social Shtetëror në planin e punës për vitin 2025 do të ketë në objektivat e tij edhe trajnimin e stafëve të institucioneve rezidenciale për të moshuar lidhur me zbatimin e standardeve të reja për të moshuarit të hyrë në fuqi në vitin 2024.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

3. Gjetje nga auditimi: Strukturat e IR publike për të moshuarit nuk janë të unifikuara dhe të përshtatura me nevojat faktike të shtëpive. Pothuajse të gjitha IR shfaqën nevojën për shtim të strukturës si në numër ashtu dhe në profesione.

3.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me bashkitë Fier, Poliçan, Gjirokastrë, Kavajë të marrin masave për rishikimin e të gjitha strukturave të IR publike për të moshuarit, duke i unifikuar dhe përfshirë në to strukturat e nevojshme për të ofruar shërbimet në përshtatje me ndryshimin e numrit të përfituesve dhe nevojave të tyre për një shërbim të sigurt dhe sipas standardeve të përkujdesit shoqëror.

Brenda vitit 2024

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Shërbimi Social Shtetëror duke u bazuar në VKM nr.135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit” si dhe nisur nga nevojat e institucioneve të përkujdesit shoqëror për përmirësimin e shërbimeve të ofruara, ka dërguar shkresën me nr. 2448/1 Prot, datë 22.04.2024 “Kërkesë për rishikim e strukturave organizative të Institucioneve të përkujdesit shoqërorë për të moshuar”, pranë Bashkiave Poliçan, Fier, Gjirokastrë dhe Kavajë për të sjellë ndryshimet, apo propozime të strukturës për institucionet e përkujdesit shoqëror për të moshuar, në mënyrë që shërbimi në këto institucione mos të ketë mangësi.

Sqarojmë se MSHMS, në bashkëpunim me SHSSH dhe institucionet e përkujdesit, me Urdhër Ministri 251/2023 për rishikimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, me asistencën teknike të Programit të Mbështetjes Buxhetore “Përfshirja Sociale” EU4SI, ka hartuar dhe janë miratuar, standardet e rishikuara të shërbimit rezidencial për të moshuar, me Udhëzimin nr.168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”. Grupi i punës është në proces të pasurimit të standardeve specifike për këtë shërbim, me standardet strukturore, ku përfshihet dhe struktura/organika e nevojshme për këtë shërbim, në bazë të numrit të përfituesve. Sa më sipër, me t’u hartuar dhe miratuara këto standarde do të rishikohen të gjitha organikat e qendrave rezidenciale publike për të moshuar. Bashkëlidhur gjeni Udhëzimin nr.168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”. Ndërkohë, Shërbimi Social Shtetëror gjatë periudhës së shqyrtimit dhe realizimit të ndryshimeve në organikat e gjashtë institucioneve rezidenciale për të moshuar, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, më kërkesën për punonjës me kontratë të përkohshme, me figurat profesionale të nevojshme, për ofrimin e shërbimit konform standardeve të përkujdesit shoqëror, me shkresë nr.3361 prot, datë 04.12.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër me gjithë përpjekjet e SHSSH ende nuk është konkluduar me një strukturë të unifikuar për të gjitha qendrat rezidenciale për të moshuar.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit kujdestar, u konstatua se nuk janë kryer periodikisht vlerësimet vjetore për stafin si dhe dosjet nuk ishin të plotësuar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar kualifikimet që nevojiten për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e planifikuara në kontratë.

4.1 Rekomandimi: Drejtuesit e Institucioneve Rezidenciale publike për të moshuarit në Tiranë, Shkodër, Fier, Poliçan, Gjirokastrë dhe Kavajë, të marrin masat për vlerësimet periodike të punonjësve dhe plotësimin e dosjeve të personelit duke përditësuar me dokumentacionin përkatës të gjitha kopjet e dosjeve të cilat administrohen në IR.

Menjëherë

Përgjigjet e subjekteve të IR Tiranë, Fier, Shkodër, Gjirokastrë, Kavajë, Poliçan:

Janë bërë vlerësimet periodike të punonjësve dhe janë plotësuar dosjet e personelit.

Performancat e punonjësve për vitin 2023 janë vjetore.

Në vazhdim do të kryejmë 6-mujore.

Janë kryer performancat 6 mujore, vjetore dhe për ata punonjës të punësuar rishtazi që përfundojnë periudhën e provës.

Qëndrimi i grupi të auditimit të KLSH:

Ky rekomandim bazuar edhe në dokumentacionin e dërguar nga subjekti nëpërmjet e-mailit apo protokollit konsiderohet i realizuar.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Nënpytja 1.2 A janë kushtet infrastrukturore të IR në përputhje, me kujdesin social? (Trajtuar më hollësisht në fq 22-31 të Raportit Përfundimtar)

1. Gjetje nga auditimi: Kushtet aktuale në rezidencat për të moshuar nuk plotësojnë nevojat e të moshuarve sipas standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit që jetojnë në qendrat rezidenciale publike. SHSSH dhe njësitë vendore nuk kanë alokuar fonde për kryerjen e investimeve në infrastrukturë, ndërtesa, pajisje dhe orendi.

1.1 Rekomandimi: Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me njësitë vendore duhet të planifikojnë fonde për investime për ndërtimin e kapaciteteve të reja akomoduese në Institucionet Rezidenciale Publike për të moshuarit apo rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese dhe për zëvendësimin e pajisjeve dhe orendive të amortizuara.

Në vijimësi

Përgjigja e subjektit SHSSH:

Shërbimi Social Shtetëror pasi ka mbledhur kërkesat për investime nga institucionet e varësisë ka hartuar listën përmbledhëse dhe ka dërguar pranë MSHMS me shkresë nr. 1914/1 prot., datë 29.03.2024 “Procedurat e hartimit të Projekt Buxhetit për vitin 2025-2027 për investime” (FAZA I) dhe me shkresë Nr.5893 prot., datë 31.07.2024 “Programin Afatmesëm për vitin 2025-2027 ”(FAZA II).

Në zbatim të VKM 850/2016 parashikohet që institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, dhe shërbimi shoqëror, që ofrohet në to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin dhe personelin. Që nga momenti i transferimit, është bashkia që përballon me

fonde shtimin e personelit apo investimet e nevojshme. Ndërkohë, gjatë vitit 2024 në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier është realizuar një investim në materiale dhe pajisje hotelerie në bashkëpunim me agjencinë TIKA. Gjithashtu në Qendrën Polivalente Poliçan gjatë vitit 2022 është nënshkruar marrëveshja mes MSHMS dhe Korpusit të Inxhinierëve të Ushtrisë Amerikane (USACE) mbi investimet e kryera për rinovimin e rrjetit elektrik, rinovimin e pjesshëm të kuzhinës, rinovimin e tualeteve si dhe të mirëmbajtjes së kanalizimeve të qendrës. Bashkëlidhur do të gjeni shkresën nr.5893 prot., datë 31.07.2024 “Programin Afatmesëm për vitin 2025-2027 ”(FAZA II).

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet në proces.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

1.2 Rekomandimi: Shërbimit Social Shtetëror të kryej një studim dhe të marrë masa për rritjen e larmishmërisë së qendrave rezidenciale dhe krijimin e institucioneve të reja, sipas nevojave dhe kërkesave të të moshuarve.

Në vijimësi

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar një analizë të numrit të kërkesave të të moshuarve për sistemim në institucionet rezidenciale për të moshuar, kërkesat për sistemime në vitet paraardhëse, numrit të kapaciteteve në qendrat e përkujdesit për të moshuar, diagnozat e të moshuarve në IR etj. Duke iu drejtuar më pas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet shkresës me nr.2741 prot, datë 08.04.2024 “Dërgim informacioni mbi Shtëpitë e të moshuarve” dhe nevojën e ngritjes së një shërbimi të ri për të moshuarit, jo autosuficientë.

Bashkëlidhur do të gjeni shkresën nr.2741 prot, datë 08.04.2024 “Dërgim informacioni mbi Shtëpitë e të moshuarve” dhe nevojën e ngritjes së një shërbimi të ri për të moshuarit, jo autosuficientë.

Sqarojmë se, MSHMS, në bashkëpunim me SHSSH dhe institucionet e përkujdesit, me Urdhër Ministri 251/2023 për rishikimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, me asistencën teknike të Programit të Mbështetjes Buxhetore “Përfshirja Sociale” EU4SI, ka hartuar dhe janë miratuar, standardet e rishikuara të shërbimit rezidencial për të moshuar, me Udhëzimin nr.168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”. Grupi i punës do të punojë për shkrimin e modelit të shërbimit, të standardeve të shërbimit të ri për të moshuarit, jo autosuficientë, ku do të parashikohen dhe standardet specifike strukturore që lidhen me infrastrukturën e godinës, pajisjen dhe strukturën që do të ofrojë shërbimin. Ky shërbim do duhet të parashikohet dhe në tipologjinë e shërbimeve, me rishikimin e kuadrit ligjor të shërbimeve të përkujdesit. MSHMS dhe SHSSH do të shikojnë mundësinë e përshtatjes së ndonjë godine ekzistuese, apo parashikimin e ndërtimit të një objekti, qoftë me fonde nga buxheti i shtetit, apo duke aplikuar në kuadër të programeve financiare të BE-së, që do të ofrohen në kuadër të procesit negociuar të integritit evropian.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër me gjithë masat serioze të marra nga SHSSH rekomandimi ende nuk është arritur të realizohet dhe konsiderohet **në proces.**

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

2.Gjetje nga auditimi: Shërbimit Social Shtetëror nuk ka bërë transferimin e plotë të Institucioneve Rezidenciale të kujdesit ndaj të moshuarve në 6 njësitë e qeverisjes vendore. Nuk janë transferuar fondet e mjaftueshme sociale nga pushteti qendror në njësitë vendore përkatëse për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ndaj të moshuarve që jetojnë në IRP. Si dhe nuk është bërë asnjë

investim dhe nuk janë planifikuar fonde për investime nga pushteti qendror dhe as nga njësitë vendore.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror të bëjnë transferimin e plotë të shërbimeve sociale të institucioneve rezidenciale të kujdesit ndaj të moshuarve në 6 njësitë e qeverisjes vendore përkatëse, nëpërmjet transfertave të mjaftueshme për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve.

Në vijimësi

Përgjigjja e subjektit MSHMS:

MSHMS nuk e ka pranuar afatin e realizimit “në vijimësi” me shkresën nr. 2007/3 prot., datë 07.12.2023 dhe ka propozuar si afat “duke filluar nga viti 2027” dhe i qëndron argumentit, konkretisht: Nisur nga kapacitetet aktuale të NJVQ-ve (Bashkitë), ku ende nuk janë ngritur strukturat e posaçme të shërbimeve sociale, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, nuk mund të realizohet procesi i transferimit të plotë të këtyre institucioneve. Nga ana tjetër, MSHMS është duke zbatuar procesin e Deinstitutionalizimit, si pjesë integrale e Strategjisë së re së Mbrojtjes Sociale 2024-2030, të miratuar me VKM 152/2024, ku transformimi i shërbimeve rezidenciale në shërbime komunitare për të moshuar, do të realizohet sipas dinamikave sociale. Sa më sipër, nga ana e MSHMS-së është propozuar në planin e masave, të dërguar me shkresë nr. 2007/6, datë 23.01.2024, që afati kohor i realizimit propozohet “duke filluar nga viti 2027”:

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

S ka përgjigje nga SHSSH në lidhje me këtë rekomandim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Siç edhe jemi shprehur dhe sqaruar më gjatë në raportin e auditimit me temë “Kujdesi ndaj të moshuarve”, në mbështetje të nenit 52, të ligjit nr. 121/2016, transferimi i plotë i qendrave rezidenciale dhe shërbimeve rezidenciale pranë njërive të qeverisjes vendore, i shoqëruar me fondet e mjaftueshme për të financuar koston e llogaritur për ushtrimin e këtyre funksioneve duhet të ishte kryer brenda dy viteve nga miratimi i ligjit të sipërcituar, thënë kjo nuk ka më vend që në vitin 2024, kur kanë kaluar gati gjashtë vite nga kërkesat ligjore MSHMS të sugjeroj për zbatimin e këtij rekomandimi një afat gati 10 vjet më shumë se sa e përcakton vet ligji.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i **pranuar dhe i pa zbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk kanë hartuar një udhëzim të përbashkët për përcaktimin e masës së kontributeve që do të paguajnë për buxhetin e shtetit të moshuarit që pranohen në Institucionet Rezidenciale Publike. Pagesa prej 40% që paguajnë pensionistët në buxhetin e shtetit bazohet në një vendim i cili nuk ka fuqi juridike pasi është tashmë shfuqizuar.

4.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, të bashkëpunojë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hartimin dhe miratimin e një Udhëzimi të përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Për përcaktimin e masës së kontributeve që do të paguajnë dhe derdhin në buxhetin e shtetit personat të moshuar që vendosen në Institucionet Rezidenciale Publike”.

Menjëherë

Përgjigjja e subjektit MSHMS:

MSHMS, me shkresën nr. 2007/3 prot., datë 07.12.2023, nisur nga fakti që një udhëzim i tillë nuk autorizohet as nga Ligji 12/2016 dhe as nga VKM 518/2018, Ministria nuk e ka pranuar as gjetjen, as rekomandimin e bërë nga ekipi auditues. Lidhur me gjetjen e sipërcituar nga grupi i auditimit, informojmë se MSHMS në fillim të vitit 2025 do të fillojë procesin e rishikimit të Ligjit 121/2016

dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku do të rishikohen kriteret e pranimit të përfituesve në qendrat rezidenciale për të moshuar, si dhe dispozitat që lidhen me masën e shpenzimeve personale të përfituesve në qendrat rezidenciale. Sugjerojmë riformulimin e rekomandimit dhe shtyrjen e afatit të realizimit nga “menjëherë” në “duke filluar nga viti 2026”.

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Shërbimi Social Shtetëror duke evidentuar problematikat e hasura me moshimin i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën me nr.1317 prot, datë 15.02.2024, me propozime për rishikimin e VKM-së 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

Kuadri ligjor do të rishikohet, proces i cili fillon në 3 mujorin e parë të vitit 2025 me ngritjen e grupit të punës për ndryshimin fillimisht të ligjit nr.121/2016 dhe do vijojë edhe me ndryshimin e VKM nr.518/2018. Bashkëlidhur do të gjeni shkresën nr.1317 prot, datë 15.02.2024 me propozime për rishikimin e VKM-së 518, datë 04.09.2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së SHSSH, ky rekomandim nuk është arritur të zbatohet por, parashikohet të realizohet brenda 3 mujorit të parë të vitit 2025. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **në** proces nga SHSSH.

Ndërsa përsa i përket komentit të dhënë nga subjekti MSHMS, nuk qëndron dhe nuk do të merret në konsideratë pasi, siç edhe e sqarojmë në raportin e auditimit, personat e moshuar që vendosen në Institucionet Rezidenciale Publike paguajnë dhe derdhen në buxhetin e shtetit kontribut bazuar në një vendim të shfuqizuar. Gjithashtu, referuar edhe rekomandimeve të Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik, roli i të cilit është thelbësor për të lehtësuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse, duke vepruar si një urë lidhëse që në rastin konkret synon përmirësimin e shërbimeve për kujdesin ndaj të moshuarve në tërësi, në mbledhjen e datës 02 dhjetor 2024 vlerësoi rëndësinë e monitorimit të mëtejshëm të aktiviteteve dhe të implementimit të masave për përmbushjen e objektivave që lidhen me përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve në institucionet rezidenciale, duke e lënë rekomandimin me afat zbatimi “Brenda qershor 2025”. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar nga MSHMS

Statusi i përgjithshëm i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar pjesërisht**.

5. Gjetje nga auditimi: Vendosja e tarifës në përqindje kundrejt vlerës së pensionit që merr i moshuari krijon pabarazi ndërmjet të moshuarve, pasi një i moshuar që merr pensionin në vlerë më të lartë paguan në shumë se një i moshuar që merr pensionin më të ulët, ndërkohë që shërbimi që ata marrin është i njëjtë.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror të kryejnë një studim dhe të shqyrtojnë mundësinë për realizimin e ndryshimeve rregullative të procedurave dhe kriterëve të pranimit të të moshuarve në shërbimin publik rezidencial.

Brenda vitit 2024

Përgjigjja e subjektit MSHMS:

Informojmë se janë realizuar dy takime gjatë muajve shkurt dhe mars 2024, me Shërbimin Social Shtetëror mbi ndryshimet e mundshme të Vendimit 518/2018 të Këshillit të Ministrave “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”. SHSSH, me anë të shkresës nr. 1317 prot., datë 15.02.2024, dhe me nr. tonë të protokollit 959, datë

19.02.2024, ka paraqitur një analizë mbi problematikat e hasura deri më sot në zbatimin e VKM 518/20218 dhe propozimet e mundshme mbi ndryshimet e këtij akti normativ. Ndërkohë MSHMS do të fillojë në fillim të vitit 2025 procesin e rishikimit të Ligjit 121/2016 dhe të akteve nënligjore.

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Shërbimi Social Shtetëror duke evidentuar problematikat e hasura me moshimin i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën me nr.1317 prot, datë 15.02.2024, me propozime për rishikimin e VKM-së 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”. Kuadri ligjor do të rishikohet, proces i cili fillon në 3 mujin e parë të vitit 2025 me ngritjen e grupit të punës për ndryshimin fillimisht të ligjit nr.121/2016 dhe do vijojë edhe me ndryshimin e VKM nr.518/2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit SHSSH, ky rekomandim nuk është arritur të zbatohet por, parashikohet të realizohet brenda 3 mujit të parë të vitit 2025.

Ndërsa mbi komentin e MSHMS, grupi i auditimit sqaron se logjika e rekomandimeve të lëna nga KLSH jepet në koherencë me gjetjet dhe periudhën e auditimit. Nga dokumentacioni i dërguar rezulton se SHSSH ka marrë masa brenda afateve që ti jepej zgjidhje problematikës dhe të zbatohet rekomandimi i lënë, ndërkohë që nga shkurti 2024 dhe deri në fillim të vitit 2025 është një periudhë shumë e gjatë e cila ka qenë mese e mjaftueshme për të vijuar me masat nga MSHMS që në rastin konkret ka shfaqur mungesë vullnetit për ta zbatuar atë.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim me shumë rezervë konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

7.Gjetje nga auditimi: Institucionet Rezidenciale Publike të kujdesit ndaj të moshuarve nuk kanë një metodologji për procedurën e kalimit të pjesës së kontributit që i takon buxhetit të shtetit dhe pjesës së pensionit që i takon të moshuarve që jetojnë në këto rezidenciale publike.

7.1Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të hartojë një metodologji dhe të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin e Sigurimeve Shoqërore për mënyrën dhe procedurat e kalimit të kontributeve që paguajnë të moshuarit në përfitim të buxhetit të Shtetit, dhe për mënyrën e kalimit të pjesës së mbetur të pensionit që u takon të moshuarve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Shërbimi Social Shtetëror i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën me nr.1317 prot, datë 15.02.2024 me propozime për rishikimin e VKM-së 518, datë 04.09.2018, ku propozohet vendosja e një tarife/kontributi për personat e moshuar që përfitojnë pension mbi kufirin e pensionit social dhe pranohen në institucion pasi janë të vetmuar dhe braktisur. Në zbatim të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, tarifa duhet të përcaktohet me Udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave.

Lidhur me këto propozime janë bërë takime me MSHMS e cila në fillim të vitit 2025 do të fillojë procesin e rishikimit të Ligjit 121/2016 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Me ndryshimet në legjislacionin për shërbimet shoqërore, që do të fillojë si proces në fillim të vitit 2025, do të rishikohen kriteret e pranimit, si dhe dispozitat që lidhen me masën e shpenzimeve personale të përfituesve në qendrat rezidenciale, e shohim të panevojshëm/parakohshëm nënshkrimin e marrëveshjes me ISSH. Sugjerohet reformulimin e rekomandimit dhe shtyrjen e afatit të realizimit

“duke filluar nga viti 2026”. Bashkëlidhur shkresa me nr.1317 prot, datë15.02.2024 “Propozim për rishikimin e VKM nr.518, datë 04.09.2018 dhe problematika të hasura mbi moshimin”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit ky rekomandim nuk është arritur të zbatohet.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i **pranuar dhe i pazbatuar**.

8.Gjetje nga auditimi: Nga viti 2018 e deri më vitin 2023 nuk është bërë në mënyrë periodike dhe sistematike indeksimi i çmimeve të konsumit, për çdo vit, të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike për të moshuarit rezidencial në IR. Në këtë udhëzim nuk janë përllogaritur shpenzimet e tjera që duhen për përkujdesjen shoqërore për një të moshuar që jeton në IRP, me qëllim planifikimin e fondeve buxhetore për vitet pasardhëse.

8.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror dhe të marrin masa për përcaktimin dhe përllogaritjen e kostos totale ditore për një të moshuar të akomoduar në Institucionet Rezidenciale Publike. Normativat e shpenzimeve dhe materialet e konsumit të ushqimeve të indeksohen çdo vit, në mënyrë sistematike, sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga INSTAT-i.

Brenda vitit 2024

Përgjigjja e subjektit MSHMS:

MSHMS nuk e ka pranuar afatin e realizimit “menjëherë” me shkresën nr. 2007/3 prot., datë 07.12.2023 dhe ka propozuar si afat “brenda vitit 2024”. Informojmë, se në kuadër të asistencës teknike EU4SI (Përfshirja Social, Programi i Mbështetjes Buxhetore) jemi duke realizuar përllogaritjen e kostos totale ditore për një të moshuar të akomoduar në Institucionet Rezidenciale Publike. Për sa i takon pjesës së dytë të rekomandimit mbi indeksimin, çdo vit dhe në mënyrë të vazhdueshme, të kuotës ushqimore, sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga INSTAT, informojmë se Shërbimit Social Shtetëror, sipas Udhëzimit të Ministrit Nr. 662/2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 689, datë 2.10.2018, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, realizon çdo vit indeksimin e kuotës ushqimore.

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Në zbatim të Udhëzimit të MSHMS nr.662 prot., datë 06.12.2022 për “Një ndryshim në udhëzimin nr.689 prot., datë 02.10.2018 Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore” Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar indeksimin e kuotës të shpenzimeve për ushqime në bazë të çmimeve të fundit të INSTAT si dhe çmimeve të tregut. Bashkangjitur Urdhri nr. 290 prot., datë 26.08.2024 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes Shoqërore”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa më sipër, pjesa e parë e rekomandimit nuk është zbatuar nga MSHMS as sipas afatit që ajo vet ka përcaktuar në planin e masave të propozuar pra, brenda vitit 2024 por rezulton akoma në proces zbatimi, ndërsa pjesa e dytë e rekomandimit mbi indeksimin çdo vit për vitin 2024 është zbatuar nga SHSSH. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i **pranuar dhe në proces**.

Për sa më lartë sqarojmë se duhen llogaritur normativat e kostos totale ditore për një të moshuar duke përfshirë të gjitha shpenzimet që duhen për ushqim dhe akomodimin. Kur flasim për normativa të shpenzimeve nuk flasim vetëm për ushqimin por, dhe për shpenzimet e tjera. (lavanteri, energji, ujë, mirëmbajtje, argëtimi, higjienë personale, etj.) Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i **pranuar dhe realizuar pjesërisht**.

Statusi i përgjithshëm i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

9. Gjetje nga auditimi: *Regjistri Elektronik Kombëtar* i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror nuk është ngritur dhe nuk funksionon, as në nivel qendror nga Shërbimit Social Shtetëror dhe as në nivel vendor nga Bashkitë, sipas kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 136, datë 07.03.2018.

9.1 Rekomandimi: Shërbimit Social Shtetëror, të ngrejë dhe azhurnojë *Regjistrin Elektronik Kombëtar* të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Bazuar në VKM Nr. 136 datë 07.03.2018 Regjistrin Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (SHKSH), si pjesë e sistemit të integruar të informacionit, mundëson regjistrimin dhe administrimin e të dhënave në nivel Bashkie, Qarku dhe në rang kombëtar për kërkuesit dhe përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për çdo tipologji shërbimi, që nga referimi i rastit deri në mbylljen e tij.

Duke pasur parasysh shtrirjen e sistemit të SHKSH pas hakërrimit të sistemit, SHSSH ka vijuar punën për rihapjen e userve në të gjitha bashkitë e vendit duke monitoruar ecurinë e regjistrit. Popullimi i regjistrit elektronik të shërbimeve shoqërore ka arritur të njihet dhe të vendoset në funksion për 61 bashki. Kjo e dhënë tregon se sistemi i SHKSH është i ngritur dhe funksional.

Sistemi i SHKSH kërkon një bashkëpunim dhe ndërveprim institucional për të arritur funksionalitetin e tij të plotë në praktikë. Ndërmjet sistemit punonjësit e bashkive janë përgjegjës kryesor për hedhjen e të dhënave dhe popullimin e regjistrit.

Për sa më lartë regjistri elektronik i shërbimeve shoqërore është funksional në 61 bashki.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Për pyetjen audituese: 2. A garantojnë institucionet rezidenciale për të moshuar, nxitjen dhe ruajtjen e shëndetit të të moshuarve?

Nënpyetja 2.1 A ofrojnë IR kujdes shëndetësor dhe mjekim sipas standardeve të shërbimeve të kujdesit për të moshuar? (*Trajtuar më hollësisht në fq 31-37 të Raportit Përfundimtar*)

1. Gjetje nga auditimi: Në Institucionet Rezidenciale për të Moshuar nuk zbatohet asnjë program, i cili parashikon ekzaminimin dhe kryerjen e vizitave apo konsultave periodike nga mjekë specialistë sipas nevojave të të moshuarve.

1.1 Gjetje nga auditimi: Asnjë nga Institucionet Rezidenciale për të Moshuar nuk është angazhuar në planifikimin periodik të vizitave dentare, me qëllim nxitjen e higjienës orale tek të moshuarit dhe vlerësimin e nevojave të tyre.

1.1 Rekomandimi: Institucionet Rezidenciale për të Moshuarit të marrin masa për administrimin e dosjes së mjekut ku ndërmjet të tjerave të përfshihet kontrata e tij e punës si dhe certifikatat për trajnimet në fushën geriatrike dhe gerontologjike në të cilat ai është angazhuar.

Në vijimësi

Përgjigjet e subjekteve të IR Tiranë, Fier, Shkodër, Gjirokastrë, Kavajë, Poliçan:

Institucioni administron dosjen e mjekut përfshirë edhe kontratën e tij të punës.

Dosja e mjekes së Institucionit u plotësua me certifikatat e trajnimeve përkatëse dhe do të vazhdoje të plotësohet me të gjitha certifikatat e trajnimeve që kryen mjekja në vazhdimësi.

Qëndrimi i grupi të auditimit të KLSH:

Ky rekomandim bazuar edhe ne dokumentacionin e dërguar nga subjekti nëpërmjet e-mailit apo protokollit konsiderohet i realizuar.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Institucionet Rezidenciale për të Moshuar nuk kanë administruar në mënyrë të plotë dosjen personale të mjekut të angazhuar në IR. Në këto dosje mungonte kontrata e nënshkruar mes palëve dhe trajnimet vazhduese të zhvilluara nga mjeku i angazhuar në institucion në fushën geriatrike dhe gerontologjike.

2.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Institucionet Rezidenciale për të Moshuarit dhe ekipin multidisciplinar të angazhuar në to të marrin masa për realizimin e programeve të vizitave periodike nga mjekë specialistë, sipas nevojave të gjendjes shëndetësore të të moshuarve si dhe të parashikohen vizita periodike dentare tek të moshuarit me qëllim nxitjen e higjienës orale dhe vlerësimit të nevojave që ata paraqesin.

Në vijimësi

Përgjigjja e subjektit SHSSH:

Shërbimi Social Shtetëror i është drejtuar 6 (gjashtë) institucioneve rezidenciale të përkujdesit shoqëror për të moshuar me shkresën me nr.1240 prot, datë12.02.2024 me kërkesën për marrjen e masave dhe angazhimin e ekipit multidisciplinar në institucionet për realizimin e programeve të vizitave periodike nga mjekë specialist dhe realizimin e vizitave periodike dentare të moshuarve me qëllim nxitjen e higjienës orale dhe vlerësimin e nevojave. Ndërkohë, gjatë vitit 2024 lidhur me shërbimin shëndetësor theksojmë se:

- gjatë monitorimit mbi ofrimin e shërbimit shëndetësor për të moshuarit, vihet re të moshuarit marrin shërbimin në bazë të sistemit të referimit;
- Klinika Stomatologjike Universitare, nëpërmjet njërive lëvizëse mundësuan ekzaminimin për të gjithë të moshuarit dhe vendosjen e protezave falas, për të moshuarit e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë. Shërbim i cili do të zhvillohet edhe në 5 institucionet e tjera rezidenciale për të moshuar. Bashkëlidhur do të gjeni shkresën nr. 1240 prot, datë12.02.2024 me kërkesën për marrjen e masave dhe angazhimin e ekipit multidisciplinar në institucionet për realizimin e programeve të vizitave periodike nga mjekë specialist dhe realizimin e vizitave periodike dentare të moshuarve me qëllim nxitjen e higjienës orale dhe vlerësimin e nevojave.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

Përgjigjja e subjektit IR Tiranë:

Gjatë periudhës Janar-Nëntor 2024. Sipas vlerësimeve dhe nevojave të të moshuarve janë kryer:

- 14- Chek up
- 5 Ndërhyrje kirurgjikale okulistike.
- Për 44 të moshuar merren mjekime periodike kronike.
- Janë kryer 11 vizita tek kirurgu.
- Janë kryer 31 vizita te mjeku psikiatër.
- Janë kryer 5 vizita te mjeku hematolog.
- Janë kryer 8 vizita te mjeku pneumolog.
- Janë kryer 3 vizita te mjeku endokrinolog.
- Janë kryer 3 vizita te mjeku neurolog.
- Është kryer një vizite te gastrohepatolog.
- Është kryer një vizite te mjeku nefrolog.

- Janë zhvilluar këshillime për higjienën orale.
- Klinika Stomatologjike Universitare, ka mundësuar kontroll dentare për të gjithë të moshuarit dhe vendosje protezash për të moshuarit të cilët kane nevojë. Shërbimi është mundësuar në qendër me ane të Shërbimit Stomatologjik të Lëvizshëm.

Përgjigjja e subjektit IR Fier:

Në lidhje me vizitat të mjekëve specialist funksionon me sistemin e referimit me rekomandime për problemet specifike të çdo të moshuari. Të moshuarit kronik vizitohen të specialisti çdo 6 muaj ose 1 vit sipas sëmundjeve përkatëse.

Për të tjera probleme jo kronike shëndetësore kartelat mjekësore të të gjithë të moshuarve janë hapur të mjeku i familjes dhe me ane të mjekes së Institucionit në baze të problemit merret rekomandim nga mjeku i familjes për të specialisti ku i moshuari duhet të vizitohet.

I moshuari shoqërohet në vizite nga mjekja e Institucionit ose kujdestarja.

Konkretisht për vitin 2024 janë kryer 135 vizita të mjekëve specialist me rekomandimet përkatëse. Pasi kryhet vizita dhe i moshuari kthehet në Institucion po i shoqëruar dhe merr mjekimin në baze të recetës së mjekut specialist.

Në lidhje me kujdesin oral ky shërbim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier ofrohet falas nga klinika TURK DENTAL e cila ka ndërtuar një mini klinike në ambientet tona ku kryen vizitat dhe le oraret për rastet kur është e nevojshme për punime si mbushje, pastrim gurëzash, vënie protezash.

Gjithashtu kemi ndihme të pa kufizuar dhe në çdo kohë nga Klinika Shtetërore Stomatologjike Poliklinika Fier.

Përgjigjja e subjektit IR Gjirokastrë:

Për vitin 2024 janë vendosur dhe kryer shërbimet: 10 vendosje proteza, 60 heqje, 20 mbushje, 10 pastrim gurëzash, 1 vendosje dhembë zirkon e gjithë goja.

Në bashkëpunim me mjekun e IR, me strukturat e NJVKSH të moshuarit janë bërë pjesë e kontrollit bazë të shëndetit, si edhe kanë kryer vizita në mjekët specialistë sipas referimit nga mjeku i IR. Kanë kryer vizita tek mjeku psikiatër, gastroenterolog, imazherist, okulist, reumatolog dhe kirurg për ndërhyrje kirurgjikale. Në lidhje me shërbimin dentar, na rezulton që pjesa dërmuese e të moshuarve janë me proteza, (1/3 e tyre) dhe pjesa tjetër ose kanë disa dhëmbë, ose asnjë. Personat që kanë patur probleme janë shoqëruar tek stomatologu. Deri tani ky shërbim është ofruar vullnetarisht nga stomatologët.

Përgjigjja e subjektit IR Poliçan:

Në bazë të shkresës me Nr., 87 Prot, dt. 26.02.2024 është mbledhur Ekipi Multidisiplinar për realizimin e një program vizitash në Poliklinikën e Specialiteteve Berat, konceptuar në bazë të nevojave dhe gjendjes shëndetësore që të moshuarit paraqesin. Këto vizita janë të pasqyruara çdo tre muaj në një raport përmbledhës si dhe të ruajtura në kartelën e tyre personale nga Mjekja e Institucionit.

Në baze të shkresës Nr. 85 Prot dt. 26.02.2024 drejtuar Drejtorisë së Shëndetit Publik Berat për realizimin e vizitave periodike dentare për nxitjen e higjienës orale të të moshuarit. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Berat në shkresën Nr. 168/1 Prot dt. 11.03.2024 ka shprehur bashkëpunimin për vizitat periodike dhe ofrimin e trajtimeve për shërbimin Oral. Janë paraqitur dy mjek Stomatolog dhe një asistues (infermier) të cilët kane bërë një depistim në Institucion si dhe hapen karte personale për çdo të moshuar.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Përgjigjja e subjektit IR Kavajë:

Mjeku i qendrës në bashkëpunim me Ekipin multidisiplinar sipas nevojave të të moshuarve kanë organizuar plan shëndeti. Kemi dërguar shkresë nr. 79, datë 14.05.2024 DSHP Kavajë për

bashkëpunim mbi vizitat dentare dhe për ofrimin e shërbimit dentar periodik për të moshuarit e institucionit tone dhe nuk kemi marre përgjigje.

Qëndrimi i grupi të auditimit të KLSH:

Në lidhje me këtë rekomandim përveç konfirmimit të subjektit nëpërmjet e-mailit dhe shkresës bashkëlidhur, nuk rezulton të ketë plan shëndeti për secilin të moshuar si dhe që për të moshuarit të jetë mundësuar kryerja e vizitave periodike dentare, në lidhje me këtë grupi i auditimit e nxit subjektin që të vazhdoj me përpjekje si duke kërkuar nëpërmjet SHSSH, MSHMS ashtu edhe nëpërmjet bashkisë Kavajë mundësimin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Shëndetit Publik Kavajë apo me subjekte të tjera të cilat do të mundësonin ofrimin e shërbimit dentar periodik për të moshuarit e institucionit tuaj. Gjithashtu, referuar përgjigjes së SHSSH për këtë rekomandim rezulton se - Klinika Stomatologjike Universitare, nëpërmjet njësive lëvizëse do mundësojë ekzaminimin për të gjithë të moshuarit dhe vendosjen e protezave falas, për të moshuarit e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë, shërbim i cili do të zhvillohet edhe në 5 institucionet e tjera rezidenciale për të moshuar, ku përfshihet edhe IR Kavajë.

Statusi i përgjithshëm i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i **pranuar** dhe **në proces**.

3. Gjetje nga auditimi: Sistemi i shërbimit social shtetëror nuk ofron qendra rezidenciale për persona jo-autosuficientë. Për rrjedhojë, pavarësisht problematikave të shëndet mendor që paraqet një pjesë dërrmuese e të moshuarve të akomoduar në institucionet rezidenciale, kjo kategori të moshuarish akomodohet në të njëjtat ambiente me të moshuarit e tjerë në qendrat rezidenciale dhe për trajtimin e tyre nuk është angazhuar asnjë mjek psikiatër në asnjë prej IR-ve publike.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për krijimin e një Institucioni Rezidencial të dedikuar për personat jo- autosuficientë, në përputhje me standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale.

Menjëherë

Përgjigjja e subjektit MSHMS:

MSHMS me shkresën nr. 2007/3 prot., datë 07.12.2023 nuk e ka pranuar afatin e propozuar nga ekipi auditues “menjëherë”, por ka propozuar si afat të realizimit të rekomandimit “brenda vitit 2024”. Informojmë se Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar analizën e dinamikës së shërbimeve rezidenciale për të moshuar, ku bazuar në nevojat dhe rekomandimin e lënë nga ju, ka bërë propozime konkrete mbi mundësinë e ngritjes së e shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuarit jo-autosuficient. Analiza është përcjellë pranë Ministrisë me shkresë me nr. 1689 prot., datë 08.04.2024. MSHMS, në bashkëpunim me SHSSH dhe institucionet e përkujdesit, me Urdhër Ministri 251/2023 për rishikimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, me asistencën teknike të Programit të Mbështetjes Buxhetore “Përfshirja Sociale” EU4SI, ka hartuar dhe janë miratuar, standardet e rishikuara të shërbimit rezidencial për të moshuar, me Udhëzimin nr.168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”. Miratimi i këtyre standardeve vjen në kuadër të procesit të rishkrimit të standardeve ekzistuese minimale në kuadër të një procesi përmirësimi të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të kujdesit social që u ofrohen qytetarëve shqiptarë, duke reflektuar eksperiencën e institucioneve tona për sa i përket zhvillimit, monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve, përafrimit me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian, si dhe duke thelluar të kuptuarin e specifikave të shërbimeve të ndryshme të kujdesit social. Grupi i punës do të punojë për shkrimin e modelit të shërbimit, të standardeve të shërbimit të ri për të moshuarit,

jo autosuficientë, ku do të parashikohen dhe standardet specifike strukturë që lidhen me infrastrukturën e godinës, pajisjen dhe strukturën që do të ofrojë shërbimin. Ky shërbim do duhet të parashikohet dhe në tipologjinë e shërbimeve, me rishikimin e kuadrit ligjor të shërbimeve të përkujdesit. MSHMS dhe SHSSH do të shikojnë mundësinë e përshtatjes së ndonjë godine ekzistuese, apo parashikimin e ndërtimit të një objekti, qoftë me fonde nga buxheti i shtetit, apo duke aplikuar në kuadër të programeve financiare të BE-së, që do të ofrohen në kuadër të procesit negociues të integritetit evropian.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Bazuar në sa më sipër rekomandimi konsiderohet në proces.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

4. Gjetje nga auditimi: Asnjë prej Institucioneve Rezidenciale për të Moshuar nuk ka në dispozicion një automjet për transportimin në rast emergjence të të moshuarve të sëmurë për në spital dhe kthimin e tyre pas rehabilitimit në qendër.

4.1 Rekomandimi: Institucionet Rezidenciale për të Moshuar të marrin masa për pajisjen e tyre me një automjet, me qëllim transportin e të moshuarve të sëmurë në rast nevojë.

Brenda 6 muajorit të dytë 2024

Përgjigjja e subjektit IR Tiranë:

Gjatë vitit 2024 IPSH nisur nga rekomandimi i lënë nga KLSH dhe përmirësimin e shërbimeve ka dërguar shkresat për mundësim automjeti: Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit Dt.15.01.2024 Nr.23 Prot dhe Ministrisë së Brendshme dt.05.02.2024 Nr.49 Prot. Gjithashtu janë bërë lobime dhe përpjekje me donatore dhe organizata për të realizuar këtë qëllim, por pavarësisht përpjekjeve deri në këto momente nuk është arritur sigurimi i një automjeti. Gjithsesi ne mbetemi të angazhuar për të adresuar dhe realizuar këtë rekomandim. Me datë 19.12.2024 jemi kontaktuar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe na është siguruar që brenda Janarit 2025 do të pajisemi me automjet për institucionin.

Përgjigjja e subjektit IR Fier:

Jemi në kontakt me disa donator dhe mendojmë se është drejt zgjidhjes sigurimi i një automjeti për të moshuarit nga “L. C. A.”. Donatori na ka komunikuar se makina është marrë dhe po kryhen procedurat dhe dokumentacionet përkatëse për sjelljen nga Italia.

Ky rekomandim ende mbetet ende në proces nga ana jonë.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces.**

Përgjigjja e subjektit IR Kavajë:

Shtëpisë së të moshuarve Kavajë i është dhënë donacion një furgon nga Presidenca e Republikës së Shqipërisë. Mjeti aktualisht nuk është në gjendje pune pasi është me mungesë dokumentacioni, taksat e papaguara dhe siguracioni i papaguar, si dhe do kontrollohet nga një mekanik për defekte të mundshme. Për këtë arsye i jemi drejtuar Bashkisë Kavajë për të kryer procedurat e mëtejshme dhe vënien në efikasitet të këtij mjeti i cili do përdoret për nevojat e institucionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:

Në lidhje me këtë rekomandim përveç konfirmimit të subjektit nëpërmjet e-mailit nuk i është bashkëlidhur asnjë shkresë apo dokumentacion tjetër justifikues i cili të vërtetojë se i është kërkuar bashkisë Kavajë për të kryer procedurat e mëtejshme dhe vënien në efikasitet të tij

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces**

Përgjigjja e subjektit Qendra Polivalente Poliçan:

Qendra Polivalente Poliçan me shkresën nr. 93 Prot ,dt. 01.03.2024 drejtuar Shërbimit Social Shtetëror dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për automjet, nga të cilat nuk ka

gjetur mbështetje në këtë kërkesë për financimin e blerjes së automjetit, duke ja deleguar këtë kërkesë Bashkisë Poliçan si bashkëpunëtorë dhe partnere në mbarëvajtjen e punëve në Institucion nëpërmjet shkresës nr. 1240/3, datë 06.03.2024.

Bashkia Poliçan në kushtet e pamundësisë financiare për realizim të blerjes së një mjeti japin në përdorim të përbashkët me Qendrën Shëndetësore Poliçan një mjet Ambulancë për tu përdorur në shërbim të të moshuarve, kundrejt mbulimit nga ana e tyre me karburant. Pavarësisht të gjitha këtyre vështirësive shërbimi ndaj të moshuarve është mbështetur totalisht nga Ambulanca e Urgjencës 24 orëshe Poliçan, si për rastet emergjente edhe për vizitat e domosdoshme periodike nga mjeke specialiste në Poliklinikën e Beratit.

Përgjigja e subjektit IR Gjirokastër:

Institucioni ynë ende nuk është pajisur me një mjet. Jemi në pritje të një mjeti dhuratë.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

Statusi i rekomandimit: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar**.

Qëndrimi i grupi të auditimit të KLSH:

Në lidhje me këtë rekomandim bazuar në përpjekjet e subjektit, si dhe në përgjigjet dhe dokumentacionin bashkëlidhur e-mailit të dërguar nga subjekti do të konsiderohet në proces

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar për IR Shkodër, i pranuar dhe në proces për IR Tiranë, Fier, Kavajë, Poliçan dhe i pranuar dhe i pazbatuar nga IR Gjirokastër.**

Statusi i përgjithshëm i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht pasi nuk është zbatuar nga IR Gjirokastër.**

5. Gjetje nga auditimi: Shërbimi Social Shtetëror nuk ka hartuar një metodologji për procesin e planifikimit të nevojave dhe përcaktimin e listës së medikamenteve që mund të mbulohen me buxhetin e vetë institucioneve rezidenciale dhe mbahen në infermierinë e tyre.

5.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartoj një metodologji për procesin e planifikimit të nevojave dhe përcaktimin e listës së medikamenteve që mund të mbulohen me buxhetin e vetë institucioneve rezidenciale dhe mbahen në infermierinë e tyre. Të gjitha Institucionet Rezidenciale Publike për të Moshuar ti referohen kësaj metodologjie gjatë procesit të planifikimit.

Në vijimësi

Përgjigja e subjektit MSHMS:

Nuk ka përgjigje nga subjekti

Përgjigja e subjektit SHSSH:

Institucionet Rezidenciale Publike për të Moshuarit ndjekin të njëjtën metodologji për procesin e planifikimit të nevojave për buxhetin e medikamenteve duke ju referuar ligjit të prokurimeve në mbështetje të buxhetit të institucioneve. Shërbimi Social Shtetëror ka ngritur një grup pune me urdhër nr. 254 prot., datë 13.06.2024 “Për të propozuar hartimin e metodologjisë për procesin e planifikimit të nevojave dhe përcaktimin e listës së medikamenteve në Institucionet rezidenciale”. Bashkëlidhur do të gjeni urdhrin nr.254 prot., datë 13.06.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së subjektit ky rekomandim konsiderohet në proces nga SHSSH pasi ky subjekt ka filluar të ndërmarri hapa për realizimin e tij, dhe i pazbatuar nga MSHMS pasi ky subjekt nuk është angazhuar për të ndihmuar në realizimin e tij, duke miratuar një metodologji pune për përcaktimin e listës së medikamenteve në Institucionet Rezidenciale gjatë procesit të planifikimit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht**.

IV. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresën nr. prot 446/17-22, datë 22.12.2023, konstatohet se pjesa më e madhe e tyre është në proces zbatimi ose e zbatuar pjesërisht. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e **16** rekomandimeve në total, nga të cilat **2** për rekomandime të pazbatuara, **3** të zbatuara pjesërisht, si dhe **11** rekomandimeve në proces zbatimi, të detajuara si më poshtë vijon:

A. MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

Për pyetjen audituese: 1 A ofron sistemi i kujdesit ndaj të moshuarve kapacitet njerëzore dhe infrastrukturore të përshtatshme për realizimin e objektivave institucionale dhe strategjike?

Nënpyetja 1.2 A janë kushtet infrastrukturore të IR në përputhje, me kujdesin social? (Trajtuar më hollësisht në fq 22-31 të Raportit Përfundimtar)

1.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për rishikimin dhe përmirësimin e kërkesave dhe kritereve të pranimit të të moshuarave në Institucionet Rezidenciale Publike.

Brenda vitit 2025

2.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, të bashkëpunojë me Institutin e Sigurimeve Shoqërore për të rregulluar dhe unifikuar moshën e përfitimit të pensionit social për personat që vendosen në IRP dhe përfitojnë falas shërbimet sociale shtetërore.

Brenda vitit 2025

B. MASA ORGANIZATIVE

Për pyetjen audituese: 1 A ofron sistemi i kujdesit ndaj të moshuarve kapacitet njerëzore dhe infrastrukturore të përshtatshme për realizimin e objektivave institucionale dhe strategjike?

Nënpyetja 1.1 A kanë institucionet rezidenciale për të moshuar burime njerëzore të kualifikuara me qëllim realizimin cilësor të shërbimeve?

1.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkitë Fier, Poliçan, Gjirokastrë, Kavajë, të marrin masat përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë me kohë të plotë dhe shoqërimin e kësaj me shtim fondi buxhetor për efektet financiare të nevojshme.

Brenda vitit 2025

2.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të marrin masa për kryerjen e trajnimeve periodike lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin e Institucioneve Rezidenciale publike për të moshuarit.

Brenda vitit 2025

3.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me bashkitë Fier, Poliçan, Gjirokastrë, Kavajë të marrin masave për rishikimin e të gjitha strukturave të IR publike për të moshuarit, duke i unifikuar dhe përfshirë në to strukturat e nevojshme për të ofruar shërbimet në

përshtatje me ndryshimin e numrit të përfituesve dhe nevojave të tyre për një shërbim të sigurt dhe sipas standardeve të përkujdesit shoqëror.

Brenda vitit 2025

Për pyetjen e auditimit 1/ Nënpyetja 1.2 A janë kushtet infrastrukturore të IR në përputhje, me kujdesin social?

1.1 Rekomandimi: Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me njësitë vendore duhet të planifikojnë fonde për investime për ndërtimin e kapaciteteve të reja akomoduese në Institucionet Rezidenciale Publike për të moshuarit apo rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese dhe për zëvendësimin e pajisjeve dhe orendive të amortizuara.

Në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Shërbimit Social Shtetëror të kryej një studim dhe të marrë masa për rritjen e larmishmërisë së qendrave rezidenciale dhe krijimin e institucioneve të reja, sipas nevojave dhe kërkesave të të moshuarve.

Në vijimësi

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror të kryejnë një studim dhe të shqyrtojnë mundësinë për realizimin e ndryshimeve rregullative të procedurave dhe kriterëve të pranimin të të moshuarve në shërbimin publik rezidencial.

Brenda vitit 2025

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror dhe të marrin masa për përcaktimin dhe përllogaritjen e kostos totale ditore për një të moshuar të akomoduar në Institucionet Rezidenciale Publike. Normativat e shpenzimeve dhe materialet e konsumit të ushqimeve të indeksohen çdo vit, në mënyrë sistematike, sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga INSTAT-i.

Brenda vitit 2025

4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror të bëjnë transferimin e plotë të shërbimeve sociale të institucioneve rezidenciale të kujdesit ndaj të moshuarve në 6 njësitë e qeverisjes vendore përkatëse, nëpërmjet transfertave të mjaftueshme për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve.

Në vijimësi

5.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të hartojë një metodologji dhe të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me Institucionin e Sigurimeve Shoqërore për mënyrën dhe procedurat e kalimit të kontributeve që paguajnë të moshuarit në përfitim të buxhetit të Shtetit, dhe për mënyrën e kalimit të pjesës së mbetur të pensionit që u takon të moshuarve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, të bashkëpunojë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hartimin dhe miratimin e një Udhëzimi të përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Për përcaktimin e masës së kontributeve që do të paguajnë dhe derdhin në buxhetin e shtetit personat të moshuar që vendosen në Institucionet Rezidenciale Publike”.

Menjëherë

Për pyetjen audituese: 2. A garantojnë institucionet rezidenciale për të moshuar, nxitjen dhe ruajtjen e shëndetit të të moshuarve?

Nënpyetja 2.1 A ofrojnë IR kujdes shëndetësor dhe mjekim sipas standardeve të shërbimeve të kujdesit për të moshuar?

1.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Institucionet Rezidenciale për të Moshuarit dhe ekipin multidisciplinar të angazhuar në to të marrin masa për realizimin e programeve të vizitave periodike nga mjekë specialistë, sipas nevojave të gjendjes shëndetësore të të moshuarve si dhe të parashikohen vizita periodike dentare tek të moshuarit me qëllim nxitjen e higjienës orale dhe vlerësimit të nevojave që ata paraqesin.

Në vijimësi

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa për krijimin e një Institucioni Rezidencial të dedikuar për personat jo- autosuficientë, në përputhje me standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale.

Brenda vitit 2025

3.1 Rekomandimi: Institucionet Rezidenciale për të Moshuar të marrin masa për pajisjen e tyre me një automjet, me qëllim transportin e të moshuarve të sëmurë në rast nevojë.

Brenda vitit 2025

4.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartoj një metodologji për procesin e planifikimit të nevojave dhe përcaktimin e listës së medikamenteve që mund të mbulohen me buxhetin e vetë institucioneve rezidenciale dhe mbahen në infermierinë e tyre. Të gjitha Institucionet Rezidenciale Publike për të Moshuar ti referohen kësaj metodologjie gjatë procesit të planifikimit.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSI 1

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Auditim performance me temë : “Kujdesi ndaj të moshuarve”

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislacioni	2	-	2	-	-	-	100%-	-	-	-	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-
2	Masa organizative	17	-	16	-	1	-	99.9%	-	3	-	4	-	8	-	-	-	2	-	-	-
3	Masa shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Për eliminimin e efekteve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	Masa disiplinore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
7	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI		19	0	18	0	1	0	100%	0	3	0	4	0	10	0	0	0	2	0	0	0